



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Lipjanit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit (KL), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Lipjanit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësi dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve në kategoritë ekonomike të ndryshme në vlerë 657,288€, përfshirë pagesa për paga jubilarë, shujta, investimet kapitale mallra dhe shërbime që janë raportuar në kategori të gabuara buxhetore.
- A2 Pasuritë kapitale janë mbivlerësuar për 188,476€, pasi tri projekte të përfunduara janë regjistruar njëkohësisht si pasuri në përdorim dhe si investime në vijim.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Lipjanit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Realizimi i sasive të kontratës me çmim për njësi, në mos përputhje me peshën e përcaktuar në dosje të tenderit.
- A4 Zyra e prokurimit në tri (3) raste kishe specifikuar emrin e prodhuesit në paramasën dhe paralogarinë e dosjes së tenderit.
- A5 Dyfishim i pozicioneve në paramasë dhe paralogari në kontratat për të njëjtin projekt.
- A6 Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë.
- B1 Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë.
- B2 Janë paguar kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore.
- B3 Vonesa në pagesën e obligimeve.
- C1 Dorëzimi i raportit narrativ dhe financiar jo i plotë nga ana e përfituesit të subvencionit.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunës së Lipjanit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Lipjanit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Lipjanit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Lipjanit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Lipjanit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Lipjanit.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keqklasifikim e shpenzimeve, mangësi në prokurim, dobësi në menaxhimin me të hyra, mos raportim i përfituesit për subvencionin e marr, mbivlerësim të pasurive, menaxhim jo të mirë të kontratave, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024, ishin realizuar pagesa nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 1,774,035€, nga kjo vlerë për kontratën kolektive ishin paguar 1,001,295€, si dhe 772,740€, për shpronësim dhe për operator ekonomik. Sipas regjistrit të komunës borxhi kryesor ishte 1,375,308€, ndërsa 398,727€, ishin shpenzime të interesit dhe shpenzime tjera procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja

Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “Shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël”. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Sipas gjetjeve të auditimit, ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 657,288€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbartimor/ të gjykatës për paga jubilarë, shujta dhe kualifikim për arsimtar nga kategori investimet kapitale 374,467€, dhe nga kategoria mallra dhe shërbime 29,122€, përveç kësaj thesari nga kategoria subvencione dhe transfere kishte paguar për investimet kapitale 83,000€, nga kategoria mallra dhe shërbimet dhe komunalit për investime kapitale 61,690€ dhe nga kategori investime kapitale për mallra dhe shërbime dhe komunalit 81,259€. Po ashtu nga kategoria mallra dhe shërbime komuna kishte paguar 27,750€, që për nga natyra i takojnë kategorisë investime kapitale.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për t'i realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore/përmbartimore si dhe planifikimit jo të mirë buxhetor.

Ndikimi Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpjen në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të komunës, ku të dhënat për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e RVF-ve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mbivlerësim i pasurive

Gjetja Neni 11 i Rregullores MF-nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore parasheh “Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim. Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësim”.

Pasuritë kapitale ishin mbivlerësuar për 188,476€, për shkak se pagesat që ishin bërë për tri (3) projekte dhe të cilat ishin përfunduar ishin regjistruar si pasuri në përdorim mirëpo të njëjtat mbahen edhe si investime në vijim. Këto kanë të bëjë me pagesa 150,000€, që ndërlidhet me kontratën asfaltimi i rrugës në fshatin Gllanicë, pagesa prej 34,845€, që ndërlidhet me kontratën asfaltimi i rrugicave në Medvec dhe pagesa prej 3,631€, që ndërlidhet me kontratën asfaltimi i rrugëve në fshatin Bujanë.

Kjo ka ndodh pasi që Thesari nuk e ka bërë korrigjimin e pasurisë edhe pse ishte kërkuar nga zyrtari i pasurisë.

Ndikimi Pasuria e mbajtur njëkohësisht si investim në vijim dhe në përdorim nuk e pasqyron gjendjen e saktë të pasurive dhe ndikon në mbivlerësim të vlerës së pasurive.

Rekomandimi A2 Kryetari në bashkëpunim me Thesar të sigurojë korrigjimin e dyfishimit të pasurive në mënyrë që ato ta prezantojnë gjendjen e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Realizimi i sasive të kontratës me çmim për njësi, në mos përputhje me peshën e përcaktuara në dosje të tenderit

Gjetja Neni 17 dosja tenderit i Rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik, paragrafi 35 parasheh se "Kurdo që Autoriteti Kontraktues (AK) nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK".

Te kontrata publike me çmim për njësi "Mirëmbajtja e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra", në vlerë parashikuar të kontratës prej 250,000€, kategoria e parë e furnizimeve dhe shërbimeve ishte peshuar me 50% a po shprehur në vlerë prej 125,000€. Kjo kategori sipas menaxherit të kontratës ishte realizuar në vlerë 175,202€, pra me një tejkalim prej 50,202€. Vlen të theksohet se kontrata në total nuk është tejkaluar pasi që pozicionet tjera ishin të përcaktuara.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve jo të mira dhe efikase të menaxhimit të kontratës nga zyrtari përgjegjës për menaxhimin e kontratës.

Ndikimi Tejkalmi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo poashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore dhe mosrealizimin e kategorive tjera të peshuara sipas kontratës.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i projektit bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike kornizë me çmim njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Specifikimi i prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë

Gjetja Neni 17 paragrafi 2 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se " Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës, përshkrimi do të përdoret, pasuar nga fjalët "ose të barasvlershme".

Zyra e prokurimit kishte përdor llojin e materialit dhe emrin e prodhuesit në

paramasën dhe parallogarinë e dosjes së tenderit. Rastet kanë të bëjë me projektin:

- “Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjera në fushat sportive në Magurë dhe Dobrajë në vlerë 1,198,386€”. Në pozicionin Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme është përdorur Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Po ashtu tek pozicioni Furnizimi transporti dhe montimi i dyerve PVC është kërkuar Prodhuesi (Salamander, Aluplast, Trocal, Rehau apo ndonjë prodhues tjetër me karakter të ngjashëm).
- “Ndërtimi i infrastrukturës së sallat e sporteve në fshatin Gillogovc dhe Rufc të ri” në vlerë 106,607€”, pozicioni 1.5 është kërkuar Pompa prodhim "GRUNDFOS" (apo ekuivalent), pozicionet 1.6, 1.7 dhe 1.8 prodhim "ARI ARMATUREN" (apo ekuivalent), pozicioni 2 Furnizimi dhe montimi i radiatorëve të tipit panel prodhim "Fabrika e radiatorëve"- Gjilan apo prodhues të tjerë me kualitet dhe karakteristika të ngjashme, pozicioni 3.1 është kërkuar Anemostatetose Prodhim S&P - Spanjë (apo prodhues të tjerë me kualitet të njëjtë).
- "Rregullimi i kuzhinës me pajisje përcjellëse të amvisërisë për shtëpinë me bazë në komunitet- Lipjan" në vlerë 10,284€, në pozicionin furrë elektrike shtëpiake është kërkuar prodhues Samsung, Beko ose të ngjashme, pozicioni i enëlarëse shtëpiake montuese është kërkuar prodhuesi LG, Beko ose të ngjashme, pozicioni i aspiratorit është kërkuar prodhuesi Beko ose ngjashëm.

Kjo ka ndodh për shkak të mungesës së kontrolleve të zyrës së prokurimit për ta parandaluar specifikimin e emrit të prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë.

Ndikimi	Specifikimi i emrit të prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës dhe trajtimit jo të barabartë të operatorëve ekonomik.
Rekomandimi A4	Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit zbaton kontrollet e duhura dhe nuk do ta lëshoj dosjen e tenderit nëse në paramasën dhe parallogarinë specifikohet emri i prodhuesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Dyfishim i pozicioneve në paramasë dhe parallogari në kontratat për të njëjtin projekt**Gjetja**

Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092, neni 28 paragrafi 2 parasheh "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik". Po ashtu neni 10 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, parasheh se "Njësia e kërkesës e cila është inicuese e kërkesës për prokurim, ndër të tjera ka përgjegjësi të sigurojë që specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës së punëve të kërkuara".

Për projektin "Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit në fshatra dhe qytetin e Lipjanit" gjatë vitit 2024, ishin lidhur dy (2) kontrata publike kornizë me çmim për njësi sipas peshimit për kategori me vlera të parashikuara me nga 300,000€, secila. Kontrata e parë ishte lidhur me 04.03.2024, për periudhë trevjeçare. Pasi që kategoria I e kontratës së parë ishte përmbushur, ishte lidhur kontrata tjetër me datë 30.12.2024, me po të njëjtin OE për periudhë dyvjeçare. Të dy kontratat ende janë aktive.

Ne kemi vërejtur se në paramasën e kontratës së dytë, ishin vendosur disa pozicione të njëjta sikurse që ishin në kategoritë e paramasë së kontratës së parë e të cilat ende nuk ishte përmbushur përqindja e realizimit. Këto pozicione me kontratën e dytë ishin kontraktuar me çmime më të larta. Këto pozicione ishin tek "Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave dhe pusetave", "Punët e dheut dhe betonit", "Gërmimi i dheut të kanalit kategoria III, IV dhe V për ndërrimin e gypit të kanalizimit dhe deblokimin e tyre dhe vendosjen e gypit sipas dimensioneve që janë në teren të vendosur".

Po ashtu për projektin e ndërtimit të palestrës sportive në fshatin Gillogovc ishin lidh dy kontrata me operator ekonomik të ndryshëm. Kontrata e parë ishte lidh me 24.10.2022, në vlerë 203,288€, përderisa kontrata e dytë që kishte të bëjë më ndërtimin e infrastrukturës së sallave sportive në Gillogovc dhe Rufc të ri ishte lidh me 15.08.2024 në vlerë 106,607€. Me kontratën e parë pozicioni i punimit të dyerve të jashtme në vlerë 1,000€, ishte realizuar përderisa ky pozicion është paraparë edhe në paramasën dhe parallogarin e kontratës së dytë, por i cili nuk ishte realizuar. Më tutje, në dy paramasat dhe parallogarit ishin të parapara pozicione të njëjta që ndërlidhen me sallën e kalldajës mirëpo që sipas menaxherit të kontratës ato kanë mbetur të pa realizuar pasi që salla është lidh me sistemin e nxehjes së shkollës dhe nuk ka pas nevojë me u vendos.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve lidhur me vendosjen e specifikave për projekte në procesin e tenderimit.

Ndikimi

Përsëritja e pozicioneve për punë të njëjta në kontrata të ndryshme, rrezikon pagesën e dyfishtë për punë të njëjta.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të shtoj kontrollet për të siguruar rritjen e përgjegjësisë tek

njësitë kërkuese lidhur me përgatitjen e specifikave për kontratat për punë, si dhe të ndërmarrë veprime për të parandaluar rreziqet e pagesave të dyfishta për punë të njëjta lidhur me projektet kapitale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë

Gjetja

Neni 54-Kontratat Kornizë respektivisht paragrafi 54.2 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (riparim/ mirëmbajtje), e cila i vendos termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes. Po ashtu paragrafi 54.15 ndër të tjera parasheh se” Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës “kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje).

Zyra e prokurimit te kontrata "Shtuarja e rrugëve fushore me zhavorr" me çmim për njësi 21.10€, me vlerë të parashikuar prej 520,000€ gabimisht kishte përdorur llojin e kontratë publike kornizë çmim njësi për punë. Kontrata publike kornizë për punë sipas rregullores lejohet vetëm në rastet kur nuk dihen sasi të indikative siç kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje por jo edhe për shtrimin e rrugëve me zhavorr, me ç'rast sasi të planifikuar kanë mundur të parashikohen nga komuna e jo të jenë të kontraktuara me sasi 1.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve nga zyra e prokurimit për t'i respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike kornizë për punë.

Ndikimi

Përdorimi i gabuar i llojit të kontratës publike kornizë me çmim për njësi për punë, mund të shkaktoj probleme gjatë realizimit të projektit për shkak se sasi të në pozicionet e paramasës dhe prallogarisë nuk janë përcaktuar si duhet.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që zyra e prokurimit zbaton kontratën e duhur ashtu siç e parasheh rregullativa ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë**Gjetja**

Neni 12 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.

Neni 3 i Ligjit Nr.08/L-224 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se për vendbanimin parësor deri në tridhjetë mijë (30,000) euro e para të pronës së vlerësuar të personit fizik i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit.

Neni 7 i Udhëzimit Administrativ Nr.03/2011 për mbledhjen dhe regjistrimin e informatave mbi pronën dhe tatimpaguesin, paragrafi 1.1 specifikon “Të dhënat për tatimpaguesin përfshijnë numrin personal identifikues (tatimpaguesit fizik)”.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë është identifikuar se 1,643 tatimpagues individual nuk kanë të prezantuar numrat personal në këtë bazë, ku prej tyre 1,182 kanë përfutur zbritjen për vendbanim parësor. Për më tepër, në gjashtë (6) raste zbritja është aplikuar dy (2) herë, dhe në një (1) rast zbritja është aplikuar tri (3) herë.

Poashtu, sipas bazës së të dhënave që kemi pranuar kemi identifikuar se në total për 14,400 tatimpagues përfutues të zbritjes për vendbanim parësor, nuk është aplikuar zbritja prej 30,000€ mirëpo vetëm 15,000€.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm për aplikimin e saktë dhe drejtë të zbritjeve për vendbanim parësor dhe mos azhurnimit të informatave për tatimpaguesit në bazën e të dhënave për tatimin në pronë.

Ndikimi

Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat identifikues personal të tatimpaguesve paraqet mangësi dhe potencialisht mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor. Poashtu, mos aplikimi i drejtë dhe saktë i vlerës së lejuar për zbritje të vendbanimit parësor ka ndikim tek mbivlerësimi i faturimit të tatimpaguesve.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të ndërmer veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve si dhe të sigurojë aplikim të saktë dhe drejtë të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor. Përditësimi i të dhënave në Protax të bëhet në baza të rregullta periodike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Kosto shtesë për shkak të pagesave përmes vendimeve gjyqësore dhe përmbartimore**Gjetja**

Neni 40.1 Ligjit Menaxhimit Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP) përcakton që kur një gjykatë nxjerr urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave.

Gjatë vitit 2024, sipas gjetjeve të auditimit nga Thesari ishin bërë pagesa në vlerë 1,774,035€, si rezultat i procedurave përmbartimore dhe vendimeve gjyqësore. Nga kjo vlerë për kontratën kolektive ishin paguar 1,001,295€, si dhe 772,740€, për shpronësim dhe për operator ekonomik. Borgji kryesor ishte 1,375,308€, ndërsa 398,727€, ishin pagesa shtesë në emër të kamatave, tarifave të përmbartimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore.

Kjo ka ndodhur si rezultat i pagesave për obligimet e dala nga kontrata kolektive për shujta, kualifikim për arsimtarët si dhe kërkesave për pagesë për shpronësime.

Ndikimi

Pagesat e realizuara përmes vendimeve gjyqësore, vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, duke krijuar kosto shtesë si rezultat i procedurave gjyqësore.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurojë informata të sakta dhe fonde të mjaftueshme për kategorinë e pagave dhe shpronësimet dhe të adresojë këtë çështje tek Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, me qëllim të shmangies së shpenzimeve në emër të kamatave, tarifave të përmbartimit dhe shpenzimeve tjera gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Vonesa në pagesën e obligimeve****Gjetja**

Neni 39.1 i LMFPP-së parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në pesë (5) mostra të obligimeve të papaguara në vlerë prej 16,821€, kemi vërejtur se komuna nuk kishte kryer pagesën e obligimeve brenda 30 ditësh nga periudha e përcaktuar ligjore. Vonesat në pagesën e faturave të obligimeve të papaguara ishin deri në 40 ditë pas përfundimit të afatit ligjor.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë

komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet financiare të jenë siguruar paraprakisht, dhe se faturat e kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C1 - Dorëzimi i raportit narrativ dhe financiar jo i plotë nga ana e përfituesit të subvencionit

Gjetja Neni 3 i kontratës së lidhur në mes komunës dhe përfituesit të subvencionit parasheh " Përfituesi duhet të raportoj tek komuna respektivisht Drejtorati për Rini, Kulturë dhe Sport duke sjell dokumentacionin sipas Rregullores MF-nr.-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe projektit të paraqitur si në vijim: raportin narrativ dhe financiar dhe kopjen e faturave".

Te subvencionimi i OJQ-së- Klubit Futbollistik Arbëria nga Dobraja e Madhe në vlerë prej 10,000€, për vlerën 3,960€, nuk ishte dorëzuar raporti narrativ dhe financiar.

Kjo ka ndodhur për shkak të papërgjegjshmërisë së zyrtarëve përgjegjës për të mbikëqyrur implementimin dhe raportimin nga OJQ-të përfituese.

Ndikimi Mungesa e monitorimit dhe raportimi i mangët nga përfituesit nuk siguron se mjetet financiare janë shpenzuar për qëllimin e përcaktuar.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës për monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara zbatojnë të gjitha procedurat ligjore me rastin e monitorimit dhe raportimit nga përfituesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 3,123,844€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 447,168€.

Çështja B4 - Mangësi në trajtimin e kërkesave për leje ndërtimore, mjedisore dhe legalizim

Gjetja

Neni 21 i Ligjit për ndërtim Nr.04/L-110, paragrafi 1 parasheh “Leja ndërtimore lëshohet nëse dokumentacioni ndërtimor përgatitet në pajtueshmëri me kushtet ndërtimore dhe në pajtim me dispozitat e këtij ligji”. Paragrafi 3 përcakton “Nëse kushtet e parapara me këtë ligj janë përmbushur dhe nëse aplikuesi ka paraqitur dëshmi për pagesën e taksës së lejes ndërtimore, organi kompetent brenda 45 ditëve për kategoritë II dhe III e lëshon lejen ndërtimore duke llogaritur nga data e paraqitjes së kërkesës”.

Neni 14 i Ligjit Nr. 06/L-024 për trajtimin e ndërtimeve pa leje, paragrafi 3 parasheh “Nëse organi kompetent vlerëson se aplikacioni është i kompletuar dhe ndërtimi pa leje kualifikohet për legalizim siç parashihet me këtë ligj” dhe paragrafi 3.9 “Organi kompetent lëshon certifikatën e legalizimit dhe dokumentet përkatëse që vërtetojnë regjistrimin në Kadastër dhe në RDPP brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pas dorëzimit të aplikacionit të kompletuar nga aplikuesi”.

Neni 6 i Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2017, paragrafi 1 parasheh “për marrjen e lejes mjedisore komunale, aplikuesi duhet t’i dorëzojë komunës kërkesën të cilës i bashkëngjitet raporti për leje mjedisore komunale”.

Gjatë auditimit të mostrave për leje ndërtimore dhe legalizim, kemi identifikuar se në dy (2) raste vendimi për dhënien e lejes ndërtimore ishte lëshuar me vonesë, ku për njërin rast vonesa ishte 14 ditë dhe në rastin tjetër 49 ditë. Poashtu, në një (1) rast, vendimi për dhënien e certifikatës së legalizimit ishte lëshuar me afër tri (3) vite vonesë, ku në rastin konkret pala kishte aplikuar për legalizim të objektit në vitin 2022 ndërsa vendimi nga komuna ishte lëshuar në vitin 2024. Ndërsa, në një (1) rast kërkesa për leje mjedisore ishte aplikuar dhe nënshkruar nga zyrtarët komunal por jo edhe nga aplikuesi sipas kërkesave të udhëzuesit.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm tek drejtoria për planifikim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit për t’i shqyrtuar kërkesat e palëve me kohë.

Ndikimi

Mangësitë e tilla kanë ndikim në përmbushjen me kohë të shërbimeve komunale ndaj bizneseve dhe qytetarëve.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë se kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim shqyrtohen brenda afateve kohore ligjore dhe se kërkesat për leje mjedisore të bëhen nga vet aplikuesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 12,618,742€, prej tyre ishin shpenzuar 12,618,742€ apo 100%. Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte më i lart për 280,699€. Ekzekutimi i pagesave sipas vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore ishte në vlerë prej 597,706€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,542 ndërsa në fund të vitit 2024 numri i tyre ishte 1,531.

Çështja A7 - Vendimet për emërimin e drejtorëve komunal nuk ishin evidentuar në librin e protokollit

Gjetja

Neni 62 i Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale , paragrafi 62.2 parasheh “Çdo drejtorat komunal menaxhohet nga drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari”.

Neni 3 i Ligjit Nr.04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë, paragrafi 2 specifikon “ Të gjitha dokumentet zyrtare duhet të kalojnë përmes njësisë për administrimin e dokumenteve, përveç në ato raste kur një gjë e tillë është e rregulluar me ligj të veçantë”, dhe paragrafi 8 e këtij neni specifikon “Aktet dhe lëndët mbahen në evidence sipas sistemit të protokolleve, librave internë dhe shenjave unike të klasifikimit sipas përmbajtjes së aktit (shkresës), si dhe në evidenca elektronike, në bazë të numrit unik të protokollit”. Neni 5 i këtij ligji, paragrafi 1 parasheh “Aktet e pranuar dhe të ndara protokollohen në evidencën themelore, me numër të protokollit në të njëjtën ditë në të cilën janë pranuar” dhe neni 6 paragrafi 1 “Në librin e protokollit regjistrohen të gjitha shkresat e pranuar sipas numrit bazë unik të protokollit”.

Kryetari i Komunës me vendim kishte emëruar (13) drejtorë të drejtorateve komunale nga data 15.03.2023 deri me datë 17.10.2024.

Gjatë fazës së auditimit në teren, nga zyra e personelit të komunës na u dorëzua vendim i Kryetarit të Komunës i protokolluar dhe evidentuar në librin e protokollit me datë 26.03.2025, i cili vendim me efekt retroaktiv emëronte drejtoreshën e drejtoratit për gjeodezi dhe kadastër nga 17.10.2024 deri në përfundimin e mandatit. Më pas nga kjo zyrë, poashtu na u dorëzuan vendimet e Kryetarit të Komunës për emërim të drejtorëve të dymbëdhjetë (12) drejtorateve tjera komunale nga 17.10.2024 e deri në përfundim të mandatit, të cilat vendime ishin datuar me 17.10.2024 dhe secili posedonte numrin e protokollit. Ne kemi gjetur se këto vendime nuk kishin kaluar/evidentuar përmes librit të protokollit pasi që sipas numrave të protokollit që posedonin këta vendime nuk u gjetën në librin e protokollit 2024. Me numrat e referencave të cilat i kishin protokollet e vendimeve u gjetën dokumente të tjera jo relevante me këto vendime si: ekstrakte të lindjes, regjistrim i pronës, kërkesë për çertifikatë të pronësisë dhe kopje të planit, ndërsa për dy (2) nga referencat protokollare të vendimeve nuk mund të gjendeshin fare më librin e protokollit.

Këto parregullsi kanë ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm në Komunë.

Ndikimi

Vendimet e Kryetarit të Komunës për emërimin e drejtorëve të drejtorive komunale që posedojnë numër protokollit mirëpo të cilat vendime nuk kishin kaluar përmes librit të protokollit dhe nuk u gjetën në librin elektronik të protokollit sipas referencave që posedonin, mund të krijojnë paqartësi në lidhje me vlefshmërinë e vendimeve të nxjerra.

Rekomandimi A7 Kryetari të sigurojë se të gjitha vendimet për emërim të drejtorëve evidentohen saktë përmes librit të protokollit komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mos harmonizimi i kontratave të punës/akt emërimeve sipas kërkesave ligjore

Gjetja Neni 102 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, paragrafi 1 parasheh “ Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës” dhe paragrafi 2 ” Aktet e emërimit dhe/apo kontratat e punës nënshkruhen nga të gjitha palët dhe duhet të jenë në harmoni me përcaktimet e këtij ligji, Ligjit të Punës, si dhe Ligjit për Paga në sektorin publik”.
 Neni 103 i këtij ligji , paragrafi 1 parasheh “Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren në afat prej një (1) viti nga hyrja në fuqi”.
 Neni 16 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paragrafi 2 specifikon “Paga bazë për nëpunësit e shërbimit publik përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit që përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcat e këtij ligji”.

Nga testimi i 72 mostrave për paga, në 46 prej tyre kemi identifikuar se kontratat e punës/akt emërimet e nëpunësve/zyrtarëve komunal në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë nuk ishin përditësuar për të reflektuar nivelin e saktë të pagës bazë - koeficientit. Përkundër faktit se pagat e këtyre nëpunësve/zyrtarëve ishin përlogaritur sipas ligjit për pagat, megjithatë kjo nuk ishte përcjellur me harmonizim edhe në kontratat e tyre të punës/akt emërimet.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e dobësive të kontrollit të brendshëm tek burimet njerëzore në drejtorinë e arsimit dhe të shëndetësisë, për t’i harmonizuar kontratat me ligjet e reja.

Ndikimi Kjo situatë ndikon në mos respektimin e kërkesave ligjore dhe krijon paqartësi, pasi që kontrata e punës/akt emërimi nuk paraqet nivelin e saktë të pagës bazë-koeficientit.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të siguroj se kontratat e punës/akt emërimet për nëpunësit/zyrtarët komunal përditësohen dhe harmonizohen sipas kornizës dhe afateve ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,543,893€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 7,211,261€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e objekteve arsimore dhe shëndetësore, rregullimin e parqeve.

Çështja C2 - Menaxhimit i kontratave jo përmes platformës së prokurimit

- Gjetja** Neni 70 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik paragrafi 10 parasheh se “Pas pranimit të njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i kontratës duhet të kyçet në sistem të prokurimit elektronik dhe duhet të filloj me fazat e menaxhimit të kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës”.
- Në tetë (8) raste* menaxherët e kontratave/projekteve nuk e kanë mbajtur menaxhimin e kontratave përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.
- Kjo ka ndodh si rezultat i dështimeve të menaxherëve të kontratave për t'i menaxhuar kontratat përmes sistemit të prokurimit.
- Ndikimi** Mosmenaxhimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.
- Rekomandimi C2** Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të bëhet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna e Lipjanit në RFV e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë totale prej 5,770,231€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë në vlerë 5,676,048€, të arkëtueshmet nga qiratë në vlerë 63,923€ si dhe të arkëtueshmet nga shpronësimi i tokës komunale në vlerë 30,260€.

Çështja B5 - Rritja e llogarive të arkëtueshme dhe mungesë e veprimeve të mjaftueshme për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Neni 26 i Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se "Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove".

Ligji Nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-055 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 6 specifikon se për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Rregulla financiare 03/2010 për të hyrat, përcakton kërkesat dhe procedurat për regjistrimin, barazimin dhe mbledhjen e të hyrave vetanake.

Gjatë testimit të 39 mostrave për llogaritë e arkëtueshme, kemi identifikuar se në 14 raste të papaguara për tatimin në pronë në vlerë 47,727€, si dhe nëntë (9) raste të papaguara në vlerë 45,756€ për qiratë-pronat komunale, komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për inkasim të llogarive të arkëtueshme, përkundër faktit se këto llogari janë bartur ndër vite. Poashtu, në krahasim me vitin paraprak, LI/A në vitin 2024 janë rritur për 763,732€ apo 15.25%.

Rritja e llogarive të arkëtueshme është si rrjedhojë e mungesës së kontrolleve të brendshme të mjaftueshme, mungesës së veprimeve të nevojshme dhe mjaftueshme në drejtim të inkasimit të LI/A, poashtu mungesës së strategjisë për inkasim.

Ndikimi

Mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^e	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	23,053,202	25,421,058	24,821,076	22,586,465	16,777,728
Grante Qeveritare - Buxheti	20,521,196	20,776,895	20,535,082	18,230,763	14,313,829
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	176,635
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,944,833	1,737,191	862,499	685,145
Të hyrat vetanake	2,532,006	2,532,006	2,387,776	2,224,126	1,413,357
Donacionet vendore	0	757	0	0	6,762
Donacionet e jashtme	0	166,567	161,027	1,269,077	182,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,367,856€. Kjo rritje ishte nga granditë e Qeverisë prej 255,699€, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 1,944,833€, si dhe donacioneve prej 167,324€.

Komuna ka shpenzuar rreth 98% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	23,053,202	25,421,058	24,821,076	22,586,465	16,777,728
Pagat dhe mëditjet	12,338,043	12,618,742	12,618,742	11,333,932	9,483,910
Mallrat dhe shërbimet	3,684,000	3,727,023	3,553,161	2,990,997	2,080,588
Komunalitë	421,616	421,616	412,179	379,853	352,924
Subvencionet dhe transferet	1,060,000	1,079,785	1,025,733	965,965	893,179
Investimet Kapitale	5,519,543	7,543,893	7,211,261	6,915,717	3,967,128
Rezervat	30,000	30,000	0	0	0

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:
Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 280,699€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës në vlerë 255,699€, si dhe rritje prej 25,000€, nga të hyrat vetjake të bartura.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 43,023€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023, për 43,005€, si dhe rritje nga donacionet për 18€.

Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për furnizime, pasje të teknologjisë informative, mirëmbajtje dhe servisim, pastrim të objekteve. Thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 29,122€, për shujta, kualifikim në arsim obligime të dala nga kontrata kolektive si dhe 56,873€ për investime kapitale.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 19,785€, nga të hyrat vetjake të pashpenzuara nga viti 2023. Shpenzimet kanë të bëjë me pagesat e bëra për përkrahjen e OJQ-ve, të individëve si dhe me shpenzimet e bëra nga thesari sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore për investime kapitale në vlerë prej 83,000€.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,024,350€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2023 për 1,857,043€, rritje nga donacionet për 167,307€. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive. Vlen të ceket se thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 374,467€, për shujta, kualifikim në arsim obligime të dala nga kontrata kolektive si dhe 81,259€, për mallra dhe shërbime dhe komunalitë.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 3,123,844€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 447,168€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	2,532,006	2,532,006	3,123,844	3,176,753	2,159,619
Të hyrat tatimore	1,581,655	1,581,655	1,360,881	1,461,266	1,237,277
Të hyrat jo tatimore	950,351	950,351	1,762,963	1,715,487	921,548
Të hyrat tjera	0	0			795

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023, kishte rezultuar me 9 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2023 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, dy (2) rekomandime ishin zbatuar, pesë (5) rekomandime nuk ishin zbatuar ende si dhe dy (2) rekomandime ishin zbatuar pjesërisht, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se kalkulimi i zbritjeve nga baza tatimore e pronave me vendbanim parësor aplikohet saktë, dhe se bëhet përditësimi i të dhënave të tatimpaguesve në Protax.	Situatë e njejtë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim shqyrtohen brenda afateve kohore ligjore, dhe se kërkesat për leje mjedisore të bëhen nga vet aplikuesit.	Raste të tilla janë përsëritur edhe në vitin 2024.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës për vlerësimin e aplikacioneve, monitorim dhe zbatim të projekteve të subvencionuara zbatojnë të gjitha procedurat ligjore me rastin e përzgjedhjes së përfituesve dhe monitorimit dhe raportimit nga përfituesit.	Sa i përket vlerësimin të aplikacioneve nuk kemi hasur ndonjë çështje, përderisa përfituesi nuk kishte ofruar raporte të plota narrative ashtu siç kërkohet.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që procedura e prokurimit për angazhimin e konsulentëve të bëhet sipas kërkesave të përcaktuara me nenin 57 të Rregullores për prokurimin publik, dhe se komisioni vlerëson ofertat në bazë të kritereve të përcaktuara me dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.	Nuk kemi hasur ndonjë çështje.	I zbatuar
5.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari duhet të sigurojë se pranimi i mallrave dhe shërbimeve apo punëve ti paraprijë urdhërblerja.	Komuna kishte ndërmarr veprimet e duhura duke e zbatuar këtë rekomandim.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë analizuar shkaqet që kanë rezultuar me mos përbushjen e obligimeve, e të cilat kanë rezultuar me ngritjen e padive dhe procedura gjyqësore. Para hyrjes në obligime të sigurohen fondet e nevojshme, si dhe të forcohen kontrollet në pagesën me kohë të obligimeve.	Nuk janë ndërmarrë veprime.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë se inicimit të projekteve kapitale ti paraprijë një planifikim i mirëfilltë nga njësia kërkuese dhe se monitorimi dhe zbatimi i projekteve kapitale të realizohet sipas paramasës dhe planit dinamik të përcaktuar me kontratë. Në rastet kur kontraktuesit nuk realizojnë punimet dhe furnizimet me kohë dhe sipas paramasës të aplikohet ndalesa e sigurisë së ekzekutimit dhe aplikimi i penaleve.	Sa i përket pjesës së rekomandimit që kishte të bëjë me realizimin, ne në mostrat tona nuk kemi hasur ndonjë çështje, ndërsa pjesa e rekomandimit që ndërlidhet me monitorimin e kontratave përmes platformës mbetet e pa zbatuar.	Pjesërisht i zbatuar

8.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim rritjen e efikasitetit në arkëtimin e të hyrave.	Gjatë vitit 2024 komuna kishte ndërmarrë veprime mirëpo nuk ishin të mjaftueshme duke marrë parasysh se trendi i rritjes së llogarive të arkëtueshme në vitin 2024 ishte 763,732€ apo 15.25%.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet financiare të jenë siguruar paraprakisht, dhe se faturat e kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave.	Edhe në vitin 2024, për shkak të mungesës së fondeve kishte vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Keqklasifikim i shpenzimeve	Nuk mund të pajtohem me Opinionin tuaj të Auditimit „Opinion i kualifikuar ” pasi që në bazën për Opinion tuaj të Kualifikuar, ka ndikuar Vendimi i Qeverisë për kontratë kolektive për pagesën e shujtave, pagave jubilarë pa planifikuar buxhet shtesë për komunat për pagesën e këtyre obligimeve që dalin nga kontrata kolektive, si dhe pa mundësin e planifikimit me buxhet nga ana e komunave .	Komuna në komentin e dhënë ka bërë vetëm arsyetime pa ofruar ndonjë dëshmi që do të ndikonin në ndryshimin e gjetjes. Prandaj, gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.
Mbivlerësim i pasurive	Mbivlerësimi i pasurive për 188,476€, edhe pse në Draft raportin e Auditimit keni cekur se keni gjetur që zyrtari i pasurive ka dërguar shkresën thesarit për mbylljen e llogarive të pasurive në vijim dhe kapitalizmin e vlerave të pasurive, nga thesari ka ndodhur gabimi që edhe pse janë regjistruar si pasuri në përdorim, ato kanë mbetur edhe më tutje të regjistruara edhe si pasuri në vijim, ky rekomandim duhet të adresohet te thesari, pasi që zyrtari i pasurive vetëm duhet me shkrim të njoftoj thesarin, ndërsa për mos veprimin e thesarit nuk bartim ne kurrfarë përgjegjësie dhe nuk kemi ndikim.	Komenti juaj paraqet më shumë një arsyetim. Ju ishit në dijeni që dërgimi i shkresës nuk ka mjaftuar për të bërë korrigjimet e nevojshme të pasurive, prandaj ishte e nevojshme dhe duhej të ndërmerren hapa të tjerë të domosdoshëm, përfshirë edhe organizimin e një takimi të drejtpërdrejtë me Thesarin, me qëllim arritjen e një zgjidhjeje të plotë dhe përfundimtare. E gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.

<p>Specifikimi i prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë</p>	<p>1. Siç e keni përshkruar edhe Ju auditor, Autoriteti kontraktues nuk ka bërë kufizimin e bendeve duke shtuar apo plotësuar me të ngjashme, ekuivalente apo edhe etj, çka do të thotë që nuk ka pasur kufizim të konkurrencës sepse OE kane mundur të ofertojnë me të gjitha bendet.</p> <p>2. Gjithashtu edhe gjatë sqarimit me ju gjatë auditimit është konstatuar që nuk ka pasur asnjë OE të eliminuar nëse ka paraqitur në ofertë pajisje tjera të cilat nuk kanë qenë të përmendura, dhe nuk ka pasur dëmtim të buxhetit apo parasë publike në asnjë raste</p> <p>3. Gjithashtu disa kontrata janë realizuar dhe përfunduar duke pranuar me pajisjet të cilat ka ofertuar me bende ekuivalentë apo të ngjashme.</p>	<p>Me Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parashihet të përdoret përshkrimi pasuar nga fjalët “ose të barasvlershme“ në rastet kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për përcaktimin e specifikimeve teknike e kërkesave përveç referencës. Po ashtu, Udhëzuesi nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, parasheh se "Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, si rregull i përgjithshëm është i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta".</p> <p>Rastet tuaj ku janë përmendur emrat e prodhuesve dhe lloj i materialit në paramasat dhe parallogaritë e projekteve, nuk kanë qenë raste të veçanta si dhe ka pasur mundësi të bëhet përshkrimi më i përshtatshëm dhe preciz i specifikave teknike pa përdor llojin e materialit dhe emrin e prodhuesit.</p> <p>Gjetja dhe rekomandimi mbetet i pandryshuar.</p>
--	---	---

<p>Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë</p>	<p>Ky Aktivitet i Prokurimit është shpallur para ndryshimeve të rregullores, Rregullores Për Prokurim Publik 001/2022, te versionit të konsoliduar 11.11.2024, e cila rregullore nuk e ka ndaluar mirëmbajtjen dhe riparimin Edhe kjo procedure është në Plan të Prokurimit tek Shërbimet shiko Planin e Prokurimit 2024, edhe kur është parapare është planifikuar në shërbime.</p> <p>Sipas nenit 54.15, AK nuk ka ditur sasinë indikativë siç kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje, duke marrë parasysh zhavorrimi, apo shtruarja me zhavorr e rrugëve nuk ka qenë e përcaktuar pasi qe nuk është ditur ndërhyrjet se ne cilat vende do te behet, dhe është kontratë kornizë pasi që shpesh herë po ka të reshura atmosferike apo vërshime, që në raste se shkaktohen dëme nëpër rruge duhet te intervenohet, qe janë intervenimet te paparashikueshme.</p> <p>Gjithashtu në këtë aktivitet të prokurimit është shpërblyer me kontratë OE i cili ka qenë me i lirë.</p>	<p>Sipas Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik, kontratat publike kornizë për punë lejohet vetëm në rastet kur kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje. Në dosjen e tenderit, si dhe kontrata ju që keni lidhur është kontratë pune për "Shtruarja e rrugëve fushore me zhavorr" dhe nuk ka të bëjë me riparim dhe mirëmbajtje. Prandaj, e gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>
---	---	---

<p>Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë</p>	<p>Ne edhe gjatë auditimit kemi sqaruar këto raste pasi që këto gabime teknike i përkasin Departamentit të Tatimit në Pronë dhe këto rekomandime duhet të adresohen në Departamentin e tatimit në Prona. Pasi që zbritja në Protax aplikohet për të gjitha pronat kuptohet për pronat primare më vlerë më të madhe se 30.000€, aplikohet zbritja prej 30.000€, ndërsa për pronat primare që kanë vlerën më ta vogël se 30.000€ aplikohet vlera e tërësishme.</p> <p>Mirëpo të dhënat nga pro-taxi të migrohet në Excel, pastaj raporti i Excel it me protax nuk paraqet drejtë sepse në Excel paraqitet që pronat primare kanë fitua zbritjen vetëm 15.000€, mirëpo me rastin e lëshimit të faturës nga programi shihet se është zbatuar zbritja prej 30.000€ , kjo vërtetohet edhe nga kartela financiare për secilin rast veç e veç. Andaj konstatimi se në 14000 raste nuk është aplikuar zbritja prej 30.000€ është i pasaktë sepse faturimi është kryer duke aplikuar zbritjen prej 30,000€ , çështja ka të bëjë me bartjen e të dhënave nga programi pro-tax në eksen të cilin veprim e kryen Drejtoria e Tatimit në Pronë pran MFT , lidhur me këtë të gjetur rekomandimin duhet adresuar ne DTP pran MFT .</p> <p>Pra janë gabime teknike , pasi që në programin Pro-tax zbritja aplikohet drejt 30.000€.</p>	<p>Komuna, në komentin e saj, ka pranuar se baza e të dhënave për tatimin në pronë, e dorëzuar gjatë fazës së auditimit, nuk përfshinte zbritjen ligjore prej 30,000€, por zbritjen prej 15,000€. Kjo mospërputhje është identifikuar nga ekipi i auditimit, i cili ka kërkuar nga komuna që të bëjë rregullimet përkatëse dhe të ofrojë një bazë të dhënash të përditësuar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Megjithatë, një bazë e tillë nuk është ofruar deri në përfundimin e auditimit.</p> <p>Është përgjegjësi e komunës që të sigurojë që të dhënat e prezantuara për auditim të jenë të plota, të sakta dhe të harmonizuara me sistemin ProTax.</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>
--	---	---

<p>Vonesa në pagesën e obligimeve</p>	<p>Ne nuk pajtohemi me konstatimin se kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur kontrolle të mjaftueshme financiare dhe ka hyre në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore , auditori nuk ka theksuar saktë shkaqet që vonesat në pagesën e faturave kanë rezultuar nga pagesat e kryera nga gjykatësi përbarimor , ku mjetet e zotuara nga një projekt janë marrë nga thesari për pagesat e kryera nga gjykata ,kështu që përkundër asaj që kemi planifikuar planin e keshit , planin e zotimit te mjeteve dhe mjetet janë zotuar për shkak të vendimeve për shujta , paga jubilarë etj , të cilat vendime nuk janë pjesë e kontrollit të brendshëm të komunës pasi që për pagesat të cilat ndikojnë në objektivat e komunës nga MFT nuk kemi buxhet shtesë .</p>	<p>Sipas Rregullës për shpenzimin e parave publike, kërkesat për furnizime dhe pranimin e shërbimeve duhet të paraprihen nga zotimi i mjeteve të nevojshme për pagesën në kohë të obligimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues. Ky kriter është ekskluzivisht pjesë e kontrollit nga ana e Organizatës Buxhetore. Prandaj, para se të bëhen kërkesat për mallra apo furnizime, komuna duhet të sigurojë fondet buxhetore të nevojshme për të mbuluar këto obligime. E gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.</p>
---------------------------------------	--	--

edhe pse janë regjistruar si pasuri në përdorim , ato kanë mbetur edhe më tutje të regjistruara edhe si pasuri në vijim , ky rekomandim duhet të adresohet te thesari , pasi që zyrtari i pasurive vetëm duhet me shkrim të njoftoj thesarin , ndërsa për mos veprimin e thesarit nuk bartim ne kurrfarë përgjegjësie dhe nuk kemi ndikim . (**Rekomandimi A2**)

- Në Draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të datës 20.05.2025 te Çështja **B1 dhe rekomandimi B1**- mangësi në Bazën e të dhënave në tatimpaguesve në pronë.
– Citojmë “Gjatë analizës së bazës së të dhënave në tatim në prone është identifikuar se 14,400 tatimpagues përfitues të zbritjes për vendbanim parësor , nuk është aplikuar zbritja prej 30.000 euro mirëpo vetëm 15.000 euro!

Komenti : Ne edhe gjatë auditimit kemi sqaruar këto raste pasi që këto gabime teknike i përkasin Departamentit të Tatimit në Pronë dhe këto rekomandime duhet të adresohen në Departamentin e tatimit në Prona. Pasi që zbritja në Protax aplikohet për të gjitha pronat kuptohet për pronat primare më vlerë më të madhe se 30.000 euro, aplikohet zbritja prej 30.000 euro, ndërsa për pronat primare që kanë vlerën më ta vogël se 30.000 euro aplikohet vlera e tërësisshme.

Mirëpo të dhënat nga pro-taxi të migrohet në Excel, pastaj raporti i Excel it me protax nuk paraqet drejte sepse në Excel paraqitet që pronat primare kanë fitua zbritjen vetëm 15.000 euro, mirëpo me rastin e lëshimit të faturës nga programi shihet se është zbatuar zbritja prej 30.000.00€ , kjo vërtetohet edhe nga kartela financiare për secilin rast veç e veç.

Andaj konstatimi se në 14000 raste nuk është aplikuar zbritja prej 30.000.00€ është i pasaktë sepse faturimi është kryer duke aplikuar zbritjen prej 30,000.00€ , çështja ka të bëjë me bartjen e të dhënave nga programi pro-tax në eksels të cilin veprim e kryen Drejtoria e Tatimit në Pronë pran MFT , lidhur me këtë të gjetur rekomandimin duhet adresuar ne DTP pran MFT .

Pra janë gabime teknike , pasi që në programin Pro-tax zbritja aplikohet drejt 30.000 euro.

Ne prapë po ua ilustrojmë me shembull konkret me nr te njëjtë te pronës si reflekton gjendja në protax dhe si pasraqitet në excel.

- Shembull :

M

Kategoria e pronës	Sipërfaqja	Normat	Vlera për banim	Nr i banimit	Nr i tatimpaguesit	Nr i personalit	Nr i valit	Nr i biznesit	Emri i babait	Emri i mbiemrit
PRONË RE SHËTËP fan	207	0.0015	210	15000	9806704417	9484008091	JO		BASHKIM HALIT	ASLLANI
PRONË RE SHËTËP fan	180	0.0015	210	15000	9806618150	1174994095	PO		BESMIR SHEFRADI	RRAHMANI
PRONË RE SHËTËP fan	162	0.0015	210	15000	9806655354	2173141087	PO		AFRIM AVDUSH	RRAHMANI
PRONË RE SHËTËP fan	173	0.0015	210	15000	9806673059	1030393500	PO		BEKIM IMER	KRENZI
PRONË RE SHËTËP fan	172	0.0015	210	15000	9806664888	1500129537	PO		LULZIM IMER	KRENZI
PRONË RE SHËTËP fan	126	0.0015	210	15000	213110245	1171485629	PO		RAMADAN RIFAT	SPAHIU
PRONË RE SHËTËP fan	157	0.0015	210	15000	2133221	1248411976	PO		METUSH AHMET	MUSTAFA
PRONË RE SHËTËP fan	70	0.0015	210	15000	2132486	1014926069	PO		SHEFKATE RUZHDI	RAMADAN
PRONË RE SHËTËP fan	126	0.0015	210	15000	2132471	1014924953	PO		BAHTI JANUZ	SPAHIU
PRONË RE SHËTËP fan	200	0.0015	210	15000	2133087	1175279748	PO		ISMET EJUP	JASHARI
PRONË RE SHËTËP fan	126	0.0015	210	15000	2133301	1030395952	PO		SHPEND HALIT	ASLLANI

0806618150
ADEM ZEHEDI / NR 07
8 BUBUSHI I MUHAMMEREVE 148/2
BUBUSHI I MUHAMMEREVE

Ta Pranis e Prapiti
Ta Chajit e Pashtrime
Orësi
Indeksi
Esportitë
Indeksi Shkëlq.

0806618150
BESHIR RRAHMANI
ADEM ZEHEDI / NR 07

Tatimpaguesi 0806618155 **Ta Gjykatë** **Annexy 2001-2000- 02.09.2015 (Annexy 2009-2014- 30.09.2015)**

Viti	E Vlerësuar				E Paguar				Balanci
	Tatimi	Kamata	Detyra	Total	Tatimi	Kamata	Detyra	Total	
2005	0.03	0.02	0.20	0.25	0.00	0.00	0.00	0.00	-0.25
2004	0.03	0.02	0.00	0.05	0.00	0.00	0.00	0.00	-0.05
2003	34.20	4.95	3.40	42.55	0.51	0.00	0.31	0.82	-41.73
2002	31.50	1.10	3.16	35.76	31.50	1.10	3.16	35.76	0.00
2001	31.00	2.50	3.16	36.66	31.00	2.50	3.16	36.66	0.00
2000	31.50	5.00	3.16	40.66	31.50	5.00	3.16	40.66	0.00
2000	31.50	8.10	3.16	42.76	31.50	9.10	3.16	43.76	0.00
2010	39.00	14.56	3.00	56.56	39.00	14.56	3.00	56.56	0.00
2017	39.00	17.00	3.00	59.00	39.00	17.00	3.00	59.00	0.00
2016	39.00	20.34	3.04	62.38	39.00	20.34	3.04	62.38	0.00
2015	39.00	0.40	1.95	41.35	39.00	0.40	1.95	41.35	0.00
2014	39.00	4.00	3.50	46.50	39.00	4.00	3.50	46.50	0.00
2013	39.00	9.40	3.50	51.90	39.00	9.40	3.50	51.90	0.00
Totale	406.26	50.87	36.35	493.48	300.31	85.40	34.03	419.74	-83.74

Ta Chajit e Prapiti **Ta Chajit e Pashtrime**

- Rasti në Exel tatimpaguesi me nr 9806618150 është zbritja prej 15.000 euro ndersa në programin protax zbritja për banim primar është 30.000 euro.

M

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja Neni 39.1 i LMFP-së parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore". Në pesë (5) mostra të obligimeve të papaguara në vlerë prej 16,821€ , kemi vërejtur se komuna nuk kishte kryer pagesën e obligimeve brenda 30 ditësh nga periudha e përcaktuar ligjore. Vonesat në pagesën e faturave të obligimeve të papaguara ishin deri në 40 ditë pas përfundimit të afatit ligjor. Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Komenti

Ne nuk pajtohemi me konstatimin se kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur kontrolle të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore , auditori nuk ka theksuar saktë shkaqet që vonesat në pagesën e faturave kanë rezultuar nga pagesat e kryera nga gjykatësi përbarimor , ku mjetet e zotuar nga një projekt janë marrë nga thesari për pagesat e kryera nga gjykata .kështu që përkundër asaj që kemi planifikuar planin e keshit , planin e zotimit të mjeteve dhe mjetet janë zotuar për shkak të vendimeve për shujta , paga jubilarë etj , të cilat vendime nuk janë pjesë e kontrollit të brendshëm të komunës pasi që për pagesat të cilat ndikojnë në objektivat e komunës nga MFT nuk kemi buxhet shtesë .

Çështja A4 - Specifikimi i prodhuesit në paramasën dhe paralogarinë e gjetuara A4 dhe Rekomandimi A4

Neni 17 paragrafi 2 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se " Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës, përshkrimi do të përdoret, pasuar nga fjalët "ose të barasvlershme". Zyra e prokurimit kishte përdorur llojin e materialit dhe emrin e prodhuesit në para masën dhe para llogarinë e dosjes së tenderit. Rastet kanë të bëjë me projektin: • "Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjera në fushat sportive në Magurë dhe Dobrajë në vlerë 1,198,386€". Në pozicionin Furnizimi dhe montimi i dyerve të brendshme është përdorur Materiali: HÖRMANN ose prodhues i cilësisë së njëjtë. Po ashtu tek pozicioni Furnizimi transporti dhe montimi i dyerve PVC është kërkuar Prodhuesi (Salamander, Aluplast, Trocal, Rehau apo ndonjë prodhues tjetër me karakter të ngjashëm). • "Ndërtimi i infrastrukturës së sallat e sportive në fshatin Gillogovc dhe Rufe të ri" në vlerë 106,607€, pozicioni 1.5 është kërkuar Pompa prodhim "GRUNDFOS" (apo ekuivalent), pozicionet 1.6, 1.7 dhe 1.8 prodhim "ARI ARMATUREN" (apo ekuivalent), pozicioni 2 Furnizimi dhe montimi i radiatorëve të tipit panel prodhim "Fabrika e radiatorëve". Gjilan apo prodhues të tjerë me kualitet dhe karakteristikat të ngjashme, pozicioni 3.1 është kërkuar Anemostatetose Prodhim S&P - Spanjë (apo prodhues të tjerë me kualitet të njëjtë). • "Rregullimi i kuzhinës me pajisje përcjellëse të amvisërisë për shtëpinë me bazë në komunitet- Lipjan" në vlerë 10,284€, në pozicionin furrë elektrike shtëpiake është kërkuar prodhues Samsung, Beko ose të ngjashme, pozicioni i enëlarëve shtëpiake montuese është kërkuar prodhuesi LG, Beko ose të ngjashme, pozicioni i aspiratorit është kërkuar prodhuesi Beko ose ngjashëm.

M

Komenti i drejtorisë së Prokurimit

Sa i përket kësaj gjetje drejtorati për prokurimi publik sqaron se:

1. Siç e keni përshkruar edhe Ju auditor, Autoriteti kontraktues nuk ka bere kufizimin e benede duke shtuar apo plotësuar me të ngjashme, ekuivalente apo edhe etj , çka do të thotë që nuk ka pasur kufizim të konkurrencës sepse OE kanc mundur të ofertojnë me të gjitha benedet.
2. Gjithashtu edhe gjatë sqarimit me ju gjatë auditimit është konstatuar që nuk ka pasur asnjë OE të eliminuar nëse ka paraqitur në ofertë pajisje tjera të cilat nuk kanë qenë të përmendura, dhe nuk ka pasur dëmtim të buxhetit apo parasë publike në asnjë rast.
3. Gjithashtu disa kontrata janë realizuar dhe përfunduar duke pranuar me pajisjet të cilat ka ofertuar me benede ekuivalente apo të ngjashme.

Çështja A6 - Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë**E gjetura A6 gjegjësisht Rekomandimi A6 –**

Neni 54-Kontratrat Kornizë respektivisht paragrafi 54.2 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (riparim/mirëmbajtje), e cila i vendos termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes. Po ashtu paragrafi 54.15 ndër të tjera parasheh se" Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshën në baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Kontratrat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje). 11 ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT - NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE - NATIONAL AUDIT OFFICE Zyra e prokurimit te kontrata "Shtuarja e rrugëve fushore me zhavorr" me çmim për njësi 21.10€, me vlerë të parashikuar prej 520,000€ gabimisht kishte përdorur llojin e kontratës publike kornizë çmim njësi për punë. Kontrata publike kornizë për punë sipas rregullores lejohet vetëm në rastet kur nuk dihen sasi të indikative siç kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje por jo edhe për shtrimin e rrugëve me zhavorr, me ç 'rast sasi të e planifikuar kanë mundur të parashikohen nga komuna e jo të jenë të kontraktuara me sasi 1. Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve nga zyra e prokurimit për t'i respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike kornizë për punë.

Komenti i drejtorisë së Prokurimit

Ky Aktivitet i Prokurimit është shpallur para ndryshimeve të rregullores, Rregullores Për Prokurim Publik 001/2022, te versionit të konsoliduar 11.11.2024, e cila rregullore nuk e ka ndaluar mirëmbajtjen dhe riparimin Edhe kjo procedure është në Plan të Prokurimit tek Shërbimet shiko Planin e Prokurimit 2024, edhe kur është parapare është planifikuar në shërbime.

Sipas nenit 54.15, AK nuk ka ditur sasinë indikativë siç kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje, duke marrë parasysh zhavorrimi, apo shtuarja me zhavorr e rrugëve nuk ka

qenë e përcaktuar pasi që nuk është ditur ndërhyrjet se ne cilat vende do të behet, dhe është kontratë kornizë pasi që shpesh herë po ka të reshura atmosferike apo vërshime, që në raste se shkaktohen dëme nëpër rrugë duhet të intervenohet, që janë intervenimet të paparashikueshme.

Gjithashtu në këtë aktivitet të prokurimit është shpërblyer me kontratë OE i cili ka qenë me i lire.

- pajtohem/ nuk pajtohem/ **pajtohem pjesërisht/** me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z.Imri Ahmeti , Kryetar i Komunës

Data: 27.05.2025,



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Ndërtimi i nënkalimit, vazhdimi i ndërtimit të sheshit, ndërtimi i parkut qendror të qytetit dhe parkingut nëntokësor në Lipjan në vlerë 6,127,777€. Hapja dhe ndërtimi i rrugëve të reja brenda qytetit të Lipjanit- Lot 1 në vlerë 629,820€. Asfaltimi i rrugicave në Krojmir, Shalë, Resinofc, Qylag, Baicë- faza III në vlerë 267,571€. Rehabilitimi i infrastrukturës në zonën e qendrës kulturore historike në fshatin Janjevë në vlerë 445,363€. Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjera në fushat sportive në Magurë dhe Dobrajë në vlerë 1,198,386€. Rikonstruimi i rrugës së shkollës në Dobrajë të Madhe dhe rrugica tjera dhe rikonstruimi i trotuareve në vlerë 297,729€. Asfaltimi i rrugicave në lagjet e fshatrave Shalë, Resionc, Qylagë, Magure, Baicë, Ribar i madh- faza IV në vlerë 491,672€ Aneks të rrjetit të kanalizimit në Lipjan, Akllap, Krojmir, Sllovi, Gracë Babush- faza II në vlerë 49,941€.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.